

VENDIM
Nr. 231, datë 14.4.2021

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN, ORGANIZIMIN DHE DETYRAT E
KOMISIONIT PËR MIRATIMIN DHE AUDITIMIN E TRUPAVE CERTIFIKUESE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 24, të ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, me propozimin e ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. QËLLIMI DHE PËRKUFIZIMET

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë përbërjen, sipas përgjegjësi, rregullat dhe procedurat për emërimin e shkarkimin e kryetarit dhe të anëtarëve të komisionit, mënyrën e funksionimit, organizimin dhe detyrat e Komisionit për Miratimin dhe Auditimin e Trupave Certifikuese (KMATC).

2. Përveç termave të parashikuar në ligjin nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”, përkufizimet në vijim kanë këto kuptime:

- a) “Ligj”, i referohet ligjit nr. 8/2019, “Për skemat e cilësisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore”;
- b) “Komision”, Komisioni për Miratimin dhe Auditimin e Trupave Certifikuese (KMATC);
- c) “Struktura përgjegjëse”, struktura përgjegjëse për skemat e cilësisë në ministri.

II. ORGANIZIMI, PËRBËRJA DHE DETYRAT E KOMISIONIT PËR MIRATIMIN DHE AUDITIMIN E TRUPAVE CERTIFIKUESE (KMATC)

1. Komisioni për Miratimin dhe Auditimin e Trupave Certifikuese (në vijim, komisioni) ka për detyrë të miratojë dhe të auditojë aktivitetin e trupave certifikuese të akredituara, në përputhje me ISO 17065:2012, sipas legjislacionit përkatës në fushën e akreditimit.

2. Në ministri ngrihet dhe funksionon komisioni, i cili përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, si më poshtë vijon:

- a) zëvendësministri i ministrisë, përgjegjës për skemat e cilësisë;
- b) drejtori i drejtorisë përgjegjëse për skemat e cilësisë, në ministri;
- c) një përfaqësues nga institucioni për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë, me eksperiencë mbi 5-vjeçare, pjesë e strukturës së kontrollit të skemave të cilësisë, sipas ndarjes së funksioneve, bazuar në analizën e riskut;
- ç) një përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, me eksperiencë në fushën e produkteve bujqësore dhe ushqimore;
- d) një përfaqësues nga Universiteti Bujqësor, nga Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit.

III. EMËRIMI DHE SHKARKIMI I KRYETARIT DHE I ANËTARËVE TË KOMISIONIT

1. Anëtarët e komisionit propozohen nga institucionet përkatëse dhe emërohen e shkarkohen me urdhër të ministrit.

2. Emërimi i anëtarëve të komisionit bëhet për një periudhë 3-vjeçare, me të drejtë riemërimi.

3. Ministri cakton, me urdhër, kryetar të komisionit zëvendësministrin përgjegjës për skemat e cilësisë.

4. Shkarkimi i kryetarit dhe i anëtarit të komisionit përpara mbarimit të mandatit bëhet me urdhër të ministrit për një nga arsyet e mëposhtme:

- a) nëse nuk paraqitet në 3 (tri) mbledhje të njëpasnjëshme të komisionit dhe nuk paraqet justifikime të provuara për këto mungesa;
- b) me kërkesën e tij për dorëheqje;
- c) kur i është ndaluar ushtrimi i profesionit me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- ç) kur shkel më shumë se 1 (një) herë në mënyrë të pajustificuar detyrimet që rrjedhin nga ky vendim;

d) nga një vendim i komisionit për thyerje të rregullave të etikës, përcaktuar në ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”. Çdo anëtar i komisionit është i detyruar të zbatojë rregullat e etikës në administratën publike;

dh) ka pamundësi shëndetësore dhe fizike që e bëjnë të paaftë të ushtrojë detyrën, të provuar nëpërmjet raportit mjekësor;

e) konstatohet se ka ushtruar vendimmarrje në kushtet e konfliktit të interesit ose të pengesës ligjore;

ë) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

f) pezullohet nga detyra.

5. Kryetari apo anëtar i komisionit që jep dorëheqjen është i detyruar të paraqesë kërkesën me shkrim për dorëheqje dhe arsyet e dorëheqjes pranë ministrit, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara datës së shkarkimit nga detyra, përveç rastit kur provon ose vërtetohet se kjo nuk ka qenë e mundur për arsyet, si më poshtë vijon:

a) të paaftësisë fizike, vërtetuar me raport mjeko-ligjor;

b) nëse ndodhet jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë;

c) nëse ka anëtarë të familjes të sëmurë, vërtetuar kjo me raport mjeko-ligjor;

ç) nëse ka rast të vdekjes së një familjari.

6. Struktura përgjegjëse merr masa për zëvendësimin sa më shpejt të kryetarit apo të anëtarit të shkarkuar apo të dorëhequr nga detyra, brenda 20 (njëzet) ditëve punë, duke bërë njoftimin në institucionet përkatëse, sipas parashikimeve të këtij vendimi. Struktura përgjegjëse përgatit urdhrin e emërimit për kandidatët për anëtarë të komisionit dhe ia dërgon për miratim ministrit. Mandati i kryetarit apo i anëtarit të ri është trevjeçar, me të drejtë riemërimi.

IV. DETYRAT E KOMISIONIT PËR MIRATIMIN DHE AUDITIMIN E TRUPAVE CERTIFIKUESE (KMATC)

1. Komisioni kryen këto detyra:

a) vlerëson kërkesën e trupave certifikuese për miratim, për kryerjen e verifikimit të përpunueshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, të regjistruara me STG EOM dhe TGJM me specifikimet përkatëse, para vendosjes së produkteve në treg;

b) miraton trupat certifikuese, nëse plotësohen kushtet e akreditimit, referuar pikës 2, të nenit 23, të ligjit;

c) pajis trupën certifikuese të miratuar me një numër identifikimi;

ç) miraton planin e kontrollit të trupave certifikuese për kryerjen e verifikimit të përpunueshmërisë së produkteve bujqësore dhe ushqimore, të regjistruara me STG EOM dhe TGJM me specifikimet përkatëse;

d) shqyrton, vlerëson dhe miraton ose dërgon për plotësim raportin vjetor të kontrollit;

dh) kryen auditimin e trupave certifikuese, duke shmangur mbivendosjen me auditin e kryer nga organizmi akreditues;

e) auditon trupat certifikuese, bazuar në raportimin vjetor të bërë prej tyre, në plotësim të planit të aktiviteteve për çështjet, sipas pikës 1, të nenit 28, të ligjit;

ë) njofton trupat certifikuese për konkluzionet dhe veprimet e duhura korrigjuese që duhet të ndërmarren, nëse është e nevojshme;

f) harton raportin përmbledhës për kontrollet për certifikimin e produkteve bujqësore ose ushqimore, të kryera nga trupat certifikuese;

g) kërkon respektimin e formës dhe të përmbajtjes së certifikatës së cilësisë nga trupa certifikuese, referuar pikës 5, të nenit 26, të ligjit;

gj) çdo detyrë tjetër, në zbatim të ligjit;

Miratimi i trupave certifikuese bëhet me urdhrë të ministrit.

2. Kryetari i komisionit (në vijim, kryetari) kryen këto detyra:

a) organizon dhe drejton punën e komisionit;

b) thërret mbledhjet e komisionit;

c) kryeson mbledhjet e komisionit;

ç) përcakton agjendën paraprake të mbledhjeve të komisionit;

d) deklaron për kushtet e konfliktit të interesit ose pengesa ligjore për një çështje të caktuar, para fillimit të mbledhjes, si dhe nënshkruan deklaratën që nuk është në kushtet e konfliktit të interesit për çdo kërkesë në shqyrtim të çdo trupe certifikimi të akredituar;

dh) ruan konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre lidhur me diskutimet, dokumentet dhe çdo informacion që u vihet në dispozicion, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale dhe interesin tregtar;

e) përfaqëson komisionin;

ë) mbikëqyr veprimtarinë e sekretariatit të komisionit;

f) raporton për ecurinë e veprimtarisë pranë ministrit.

3. Anëtarët e komisionit kryejnë këto detyra:

a) kryejnë detyrat sipas përcaktimeve të ligjit dhe të këtij vendimi;

b) marrin pjesë në mbledhjet e komisionit dhe, në rast mungese, njoftojnë kryetarin për arsyen e mungesës;

c) deklarojnë për kushtet e konfliktit të interesit ose pengesa ligjore për një çështje të caktuar, para fillimit të mbledhjes, si dhe nënshkruajnë deklaratën që nuk janë në kushtet e konfliktit të interesit për çdo kërkesë në shqyrtim të çdo trupe certifikimi të akredituar;

ç) kryejnë përgatitjen paraprake thelbësore për mbledhjet e komisionit, sipas agjendës së paraqitur në njoftimin e mbledhjes;

d) kryejnë detyra specifike të përcaktuara nga vendimet e komisionit;

dh) marrin vendime;

e) ruajnë konfidencialitetin e informacionit të marrë gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre lidhur me diskutimet, dokumentet dhe çdo informacion që u vihet në dispozicion, sipas legjislacionit në fuqi për ruajtjen e të dhënave personale dhe interesin tregtar.

Përcaktimet sipas shkronjave “c” dhe “e”, të kësaj pike, do të jenë të aplikueshme edhe në rastet kur nga kryetari apo anëtarët e komisionit janë ftuar ekspertë për konsultime që kanë të bëjnë me çështjen, duke nënshkruar një deklaratë për ruajtjen e konfidencialitetit dhe konfliktin e interesit.

4. Procedurat/mënyrat e zhvillimit të mbledhjeve dhe vendimmarrja e KMATC-së, si dhe detyrat e kryetarit dhe të anëtarëve të komisionit rregullohen nga parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe përcaktimet e ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999, “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

5. Komisioni do të mbështetet nga struktura përgjegjëse në ministri, për skemat e cilësisë, si dhe sekretari teknik, pjesë e strukturës përgjegjëse.

V. SHPËRBLIMI I KRYETARIT DHE I ANËTARËVE TË KOMISIONIT

Kryetari dhe anëtarët e komisionit shpërblehen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

VI. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Komisioni ngrihet brenda 60 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

2. Ngarkohet Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe